

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Keshilli i Ministrave

UDHEZIM

Nr. 1 date 1.01.1996

PER

PROKURIMIN PUBLIK

ndryshuar me Udhezimin e Keshillit te Ministrave nr.1, date 24.5.2002, dhe me Udhezimin e Keshillit te Ministrave nr.3 date 10.07.2003

Me propozim te Agjencise se Prokurimit Publik, Keshilli i Ministrave

U D H E Z O N

KAPITULLI I

ENTI PROKURUES DHE URDHERI I PROKURIMIT.

1. Enti prokurues eshte organi qendror ose lokal, te cilit i jane vene ne dispozicion fonde per prokurim, kur e kryen vete prokurimin e tyre. Ne rast se kryerjen e prokurimit organi qendror ose lokal ia delegon me shkrim nje personi tjeter juridik, atehere ky i fundit ka detyrat dhe pergjegjesite e nje enti prokurues te mirefillte.

2. Titullari i entit prokurues, pas akordimit te fondit, nxjerr urdherin e prokurimit, ne te cilin percakton:

- a) objektin e prokurimit;
- b) fondin limit te vene ne dispozicion;
- c) proceduren e prokurimit;
- d) komisionin e vleresimit te ofertave;
- e) hartuesit e dokumentave te tenderit, atje ku nuk ka njesi prokurimi.

3. Percaktimi i fondit limit argumentohet nga enti prokurues dhe behet ne baze te çmimeve te publikuara nga INSTAT-I dhe institucionet e tjera shtetere, perkatese. Per çmimet e papublikuara, percaktimi i fondit limit te behet ne baze te pervojes se meparshme te entit prokurues ose sipas testimit te tregut.

Ne qoftese keto te dhena nuk sigurohen nga burimet e mesiperme, enti prokurues mund te perdore publikimet nderkombetare.

4. Ne rastin kur objekti i prokurimit eshte ndare ne artikuj apo grup artikujsh, per secilin prej tyre te percaktohen fondi limit, kur enti prokurues kerkon te shpalle me shume se nje fitues.

KAPITULLI II

PROCEDURAT E PROKURIMIT

1. Procedura e prokurimit vendoset ne mbeshtetje te ligjit nr.7971 dt.26.07.1995 "Per Prokurimin Publik" dhe vendimeve te Keshillit te Ministrave.

2. Ne asnje procedure prokurimi nuk mund te percaktohen kufij maksimale apo minimale mbi bazen e te cileve, ofertat qe jane mbi ose nen keta kufij, skualifikohen.

(a) Procedurat e tenderave te hapur dhe nderkombetare

Procedure hapur eshte ajo procedure qe i drejtohet kryesisht shoqerive vendase, por qe lejon edhe pjesemarrjen e shoqerive te tjera, pavaresisht nga **shtetesia**, ku dokumentat e tenderit do te hartohen vetem ne shqip, ofertat do te pranohen vetem ne shqip dhe njoftimet do te botohen vetem ne shtypin vendas.

Procedure nderkombetare eshte ajo procedure qe i drejtohet te gjitha shoqerive te cdo **shtetesia**, ku dokumentat e tenderit do te hartohen ne shqip dhe ne nje gjuhe tjetere qe perdoret gjeresisht ne tregtine nderkombetare dhe njoftimet, pervec buletinit te Agjencise se Prokurimit Publik dhe gazetave kombetare, sipas nenit 25 te ligjit 7971 dt.26.07.1995 do te behen edhe ne nje gazete nderkombetare qe perdor te njejten gjuhe si ftesa per oferte dhe qe ka tirazh te mjaftueshem per te nxitur konkurrencen.

Procedura e preferuar e prokurimit do te jete ajo e hapur, per arsye te shfrytezimit te burimeve njerezore vendase dhe avantazheve ne lidhje me zhvillimin e tenderave sepse:

- afatet jane te shkurtra, prandaj prokurimi behet me shpejt;
- ka lehtësi gjeografike ne lidhje me distancat ndermjet kontraktuesit dhe punedhenesit;
- njoftimi behet vetem ne buletin e agjencise dhe shtypin vendas, prandaj eshte me ekonomik;
- perdoret gjuha vendase;
- ka fitim ne kohe ne shkembimin e njoftimeve, takimeve dhe sqarimeve perkatese, marrjen e materialeve shtese (kur duhen), etj.;
- ligjet dhe rregullat e prokurimit konsiderohen te njohura paraprakisht, prandaj keqkuptimet menjanohen ne maksimum, duke lehtesuar komunikimin.

Kjo procedure do te perdoret gjithnje, kur me ane te saj mund te arrihet nje konkurrence e efektshme, sipas kufijve monetare te dhena ne vendimet e Keshillit te Ministrave. Ne rast te kundert, do te kalohet ne procedurat nderkombetare, sipas nenit 41 te ligjit nr.7971 dt.26.07.1995 "Per Prokurimin Publik".

(b) Procedurat e parakualifikimit

Procedura e parakualifikimit perdoret sipas nenit 13 te ligjit 7971 dt.26.07.1995, ne rastet kur objekti i prokurimit eshte kompleks dhe kerkohet nje pune e madhe per pergatitjen e ofertave dhe shqyrtimin e vleresimin e tyre.

Kjo procedure inkurajon shoqerite per pjesemarrjen ne fazen parakualifikuese, sepse dokumentacioni qe duhet paraqitur ne kete faze, nuk kushton shume kohe dhe shpenzime.

Kjo procedure gjithashtu i jep mundesine entit prokurues t'u dergoje ftesa per paraqitjen e ofertave tekniko-ekonomike vetem shoqerive te parakualifikuara, qe kane aftesi dhe burime te mjaftueshme per te konkurruar duke kufizuar numrin e shoqerive qe do te paraqesin oferta (pas parakualifikimit).

Njoftimi ne proceduren parakualifikuese behet sipas kufijve kohore te tenderit te hapur dhe atij nderkombetar.

Ne dokumentat e parakualifikimit do te kerkohet qe pjesemarresit te plotesojne te gjitha kushtet e percaktuara ne nenin 12/1 te ligjit nr. 7971 date 26.07.1995 "Per prokurimin publik".

Menjehere pas perfundimit te procedures se parakualifikimit, pjesemarresve te kualifikuar u shperndahen dokumentat e tenderit.

Per paraqitjen e ofertes tekniko-ekonomike, sipas gjykimit te entit prokurues dhe ne varesi te objektit te prokurimit, afati i paraqitjes se tyre do te jete 10 deri ne 20 dite.

Verifikimi i informacionit te dhene ne paraqitjen e dokumentacionit per parakualifikim do te konfirmohet para nenshkrimit te kontrates fituese. Nese ky informacion rezulton i rreme, i pasakte ose jo i plote, ofertuesi skualifikohet ne baze te nenit 12, pika (5) dhe (6) te ligjit nr.7971 dt.26.07.1995. Ne kete rast enti prokurues shpall fitues konkuresin qe rezulton i dyti ne klasifikim.

Procedura parakualifikuese mund te zbatohet edhe per grupe te caktuara objektesh te te njejtit lloj, duke caktuar nje fond kufi, nen te cilin parakualifikimi nuk eshte i nevojshem.

Ne kete rast parakualifikimi do te jete i vlefshem per nje periudhe te caktuar kohe, e cila duhet te jepet ne dokumentat e procedures parakualifikuese, periudhe mbas se ciles procedura e parakualifikimit duhet te perseritet. Ne keto dokumenta duhet te vendoset edhe nje limit per numrin ose vleren e pergjithshme te kontratave fituese per cdo pjesemarrës ne tender, mbi bazen e burimeve te ketij te fundit.

(c) Tenderi me dy faza

"Tenderi me dy faza" do te perdoret ne raste kur projektimii hollesishem dhe teknologjia e mallrave dhe punimeve qe do te prokurohen paraqesin veshtiresi ne pergatitjen e specifikimeve teknike dhe dokumentave te tjera te tenderit.

Kjo **procedure** mund te ndodhe (ne rastet e kontratave me "celesa ne dore"ose te kontratave per impiante apo punime te medha e komplekse te nje natyre te vecante), kur pergatitja paraprake e specifikimeve te plota teknike do te ishte e veshtire ose jo praktike dhe enti prokurues e quan me te arsyeshme qe te mbledhe me pare propozimet e shoqerive pjesemarrëse.

Kjo procedure prokurimi eshte e pershtatshme edhe ne rastet e pajisjeve qe i nenshtrohen perparimeve te shpejta teknologjike, si sistemet kryesore informatike dhe te komunikimit.

"Faza e pare e Tenderit" me dy faza mund te behet e hapur ose e kufizuar, ne mbeshtetje te ligjit nr.7971 dt.26.07.1995 "Per Prokurimin Publik" dhe vendimeve te Keshillit te Ministrave, duke respektuar kufijte monetare dhe afatet kohore te dhene ne vendim. Faza e dyte e "Tenderit me dy faza" do te respektoje kufijte kohore te "Tenderit te kufizuar".

(ç) Kerkesa per propozim

"Kerkesa per propozim" eshte nje lloj tenderi i kufizuar, ku numri i ofertave kushtezohet nga numuri i shoqerive ose personave te afte per te paraqitur propozime te vlefshme.

Nese "Kerkesa per propozim" behet nderkombetare, enti prokurues duhet te kerkoje propozime ne jo me pak se tre shtete.

"Kerkesa per propozim" mund te behet me ose pa parakualifikim.

Kur enti prokurues do te perdore "Kerkesen per propozim", pa zbatuar proceduren parakualifikuese, duhet te perpiloje me pare nje liste te shkurtuar te shoqerive ose personave qe kane aftesi te paraqesin propozime te vlefshme.

Kjo procedure prokurimi mund te perdoret ne rastet e konsulencave, studimeve, projekteve te beshmerise, drejtimet te punimeve,etj.

Dokumentat e tenderit duhet te permbajne termat e references, llojin dhe cilesine e propozimit te kerkuar, si dhe te gjitha aktet ligjore dhe nenligjore (n.q.s. ka), rregullat, standarte, kushtet teknike ku do te mbeshtetet lloji i propozimit te kerkuar.

(d) Kerkesa per kuotim

“Kerkesa per kuotim” perdoret kur ndertimet, sherbimet apo mallrat qe do te prokurohen kane nje treg te stabilizuar dhe vlera e kontrates eshte e vogel.

Kjo procedure prokurimi eshte nje lloj tenderi i kufizuar qe ka avantazhe ne krahasim me format e tjera te prokurimit, sepse koha e nevojshme per kryerjen e prokurimit eshte me e shkurter dhe kerkesat per kualifikim me te reduktuara.

Per siper marrjet e ndertimit dhe sherbimet kerkoet vetem dokumentacioni ligjor dhe administrativ, kurse per blerjet kushtet e ofertes do te perfshihen ne nje porosi blerjeje dhe kuotimet mund te pranohen edhe me fax ose me poste elektronike. Dokumentacioni ligjor dhe administrative do t'i kerkoet vetem shoqerise fituese, para lidhjes se kontrates.

“Kerkesa per kuotim” do te behet kombetare vetem kur ofertat per ndertimet, sherbimet ose mallrat mund te merren nga **jo me pak se tre** burime dhe me cmime konkruuese. N.q.s. “Kerkesa per kuotim” do te behet nderkombetare, enti prokurues do te kerkoje kuotime ne jo me pak se tre shtete.

“Kerkesa per kuotim” mund te behet me ose pa parakualifikim.

(dh) Prokurimi i drejteperdrejte

Kur enti prokurues perdor proceduren “Prokurim i drejteperdrejte”, hyn ne mardhenie dhe kerkon propozim nga nje kandidat, si dhe negocijon per kushtet e kontrates. Prokurimi i drejteperdrejte nuk duhet te perdoret, ne asnje rast, per te menjanuar konkurrencen e mundshme apo per te diskriminuar kandidatet.

Enti prokurues duhet te pergatise per kete procedure nje pershkrim te shkurter te nevojave dhe kerkesave te vecanta, si p.sh. per cilesine, sasine, kushtet dhe afatet e levrimet dhe me pas te negociroje me kandidatin e vetem.

KAPITULLI III

DOKUMENTET E TENDERIT

Dokumentet e tenderit perbehen nga **(a) pjesa e pergjithshme**, sipas formulareve te bashkelidhur ketij udhezimi, ku perfshihen:

- ftesa per oferte;
- udhezime per pjesemarrjesit ne tender;
- formulari i ofertes;
- kushtet e vecanta dhe te pergjithshme te kontrates;
- kerkesat per kualifikimin e pjesemarrjesve;
- formulari i sigurimit te ofertes;
- te dhenat e ofertes;
- sigurimin e kontrates;
- njoftimin e fituesit;
- **formulari i kontrates**
- **formulari i autorizimit te prodhuesit**

dhe **(b) pjesa e vecante**, ne perputhje me llojin e prokurimit, ku perfshihet:

1. Per prokurimin te ndertimeve:

- projektet e zbatimit dhe specifikimet teknike;
- preventivi
- grafiku per kryerjen e ndertimeve

2. Per prokurimin e mallrave:

- specifikimet teknike;
- grafiku i levrim;it;

3. Per prokurimin e sherbimeve te projektimit:

- termat e references
- grafiku i zbatimit
- kerkesat per personelin kryesor
- skedari i tarifave, kostove dhe shpenzimeve, nese kerkohet

(a) Pjesa e Pergjithshme

- **Ftesa per oferte** permban emrin dhe adresen e entit prokurues, fondin e vene ne dispozicion, objektin dhe proceduren e prokurimit, vendin dhe **vleften** e terheqjes se dokumentave te tenderit, vendin, daten dhe oren e hapjes se tenderit.

- **Udhezimet per pjesemarresit ne tender** duhet te permbajne gjithë informacionin e nevojshem per te pergatitur oferten per mallrat dhe punimet a sherbimet qe do te prokurohen.

Pjesemarresit ne tender do te perdorin dokumentat standart te tenderit dhe kushtet e pergjithshem te kontrates pa bere ndryshime **ne to**. Ndryshimet do te jepen vetem nepermjet te dhenave te ofertes dhe kushteve te vecanta te kontrates.

Per tenderat nderkombetare dokumentet e tenderit duhet te pergatiten ne shqip dhe ne anglisht (ne qofte se ne marreveshjet perkatese nuk eshte parashikuar ndryshe), duke specifikuar tekstin e vlefshem ne njeren prej gjuheve te perdorura. Per tenderat kombetare gjuha e ofertes do te jete gjuha shqipe.

Gjithe pjesemarresve ne tender duhet t'u krijohen mundesi te barabarta per te pare sheshet e ndertimit te objekteve te medha e komplekse si dhe mund te organizohet nje konference paraprake (edhe ne rastin e levrimeve), ne te cilen gjithë pjesemarresit e mundeshem ne tender mund te kerkojne sqarime ne lidhje me paqartesite qe u kane lindur gjate pergatitjes se ofertes. Sqarimet do te kerkojen me shkrim dhe, pasi te pergatiten nga enti prokurues, do t'u shperndahen te gjithë kandidateve pa perjashtim.

Secilit kandidat do t'i dergohet cdo korigjim ose ndryshim ne dokumentat e tenderit, brenda nje periudhe te mjaftueshme kohe, perpara afatit te fundit te marrjes se ofertave.

Ne dokumentat e tenderit duhet te percaktohet monedha ose monedhat me te cilat pjesemarresit do te shpallin cmimet e tyre, procedurat e konvertimit te cmimeve te shprehur ne monedha te ndryshme (jo me shume se tre) ne nje monedhe te vetme, per efekt te krahasimit te ofertave si dhe monedhat ne te cilat do te kryhet pagesa per vleften e kontrates. Kursi i kembimit te monedhave duhet te jete kursi i shitjes i **Bankes se Shqiperise** i 28 diteve perpara dates se hapjes se tenderit. Ne kete menyre eliminohet rreziku i keqkuptimit ne kembimin valutor, sigurohet ndershermeri dhe transparence gjate procesit te vleresimit dhe u jepet mundesia pjesemarresve ne tender nga vendet me monedhe me te dobet per te perdorur nje monedhe me te forte. Pjesa e cmimit te ofertes qe perfshin koston e brendshme duhet te jepet ne leke.

Ne dokumentat e tenderit duhet te theksohet gjithashtu se ofertuesi, gjate hartimit te ofertes duhet te perfshije te gjitha detyrimet fiskale qe jane ne fuqi 28 dite perpara hapjes se ofertave.

-**Formulari i ofertes** duhet te permbaje konfirmimin e kandidatit per vleren me te cilen ai merr persiper realizimin e kontrates si dhe deklaraten qe oferta e tij eshte ne perputhje me kushtet e kontrates dhe specifikimet teknike te dhena ne dokumentat e tenderit.

- **Kushtet e pergjithshme te kontrates** duhet te perkufizojne gamen e punes qe do te kryhet, mallrat qe do te levrohen, te drejtat dhe detyrimet e entit prokurues dhe kontraktuesit si dhe funksionet dhe kompetencat e sipermarresit dhe Drejtorit te Punimeve ne mbikqyrjen dhe administrimin e kontrates. Vec kushteve te pergjithshme te kontrates do te jepen edhe kushtet e vecanta per mallrat dhe punimet specifike qe do te prokurohen. Ne kushtet e vecanta te kontrates jepet shuma e nevojshme per sigurimin e kontrates qe do te sherbeje per mbrojtjen e entit prokurues ne rastin e shkeljes se kontrates nga ana e kontraktuesit. Nje pjese e kesaj garancie do te shtrihet pertej dates se perfundimit te punimeve per te mbuluar pergjegjesite per difektet ose mirembajtjen deri ne marrjen ne dorezim nga enti prokurues. Kontrata mund te parashikojte edhe mbajtjen e nje perqindje ne cdo pagese periodike deri ne marrjen ne dorezim te objektit.

- **Kerkesat per kualifikim** duhet te permbajne dokumentacionin ligjor dhe administrativ te kandidatit, te cilat enti prokurues i vlereson te nevojshme per realizimin e kontrates, ne perputhje me nenin 12 te ligjit nr.7971 dt.26.07.1995 "Per Prokurimin Publik". Per sipermarrjet dhe projektimet, ne kerkesat per kualifikim do te bejne pjese, pervec dokumentacionit ligjor dhe administrativ, edhe te dhena te tjera per personelin, aftesite teknike dhe pervojat e shoqerise.

- **Formulari i sigurimit te ofertes** sherben per te mbrojtur entin prokurues nga ofertat e papergjegjeshme. Formulari i sigurimit te ofertes do te kete formen e nje depozite a garancie, te leshuara nga nje banke ose nga shoqerite e licensuare nga shteti per kete qellim. Sigurimi i ofertes u çngurtesohet menjehere ofertuesve te pasuksesshem. Kandidateve te tjere ky sigurim u kthehet pas lidhjes se kontrates.

Enti prokurues do te percaktojte perqindjen e sigurimit te ofertes ne varesi te vleres se fondit limit, sipas rregullave te prokurimit publik, te percaktuara me vendim te Keshillit te Ministrave, duke synuar kufirin minimal per kontratat me vlere te madhe dhe kufirin maksimal per kontratat me vlere te vogel.

(b) Pjesa e vecante

1. Per prokurimin e ndertimeve

Per **prokurimin** e ndertimeve, projekti duhet te jete i perfunduar ne fazen e projektzbatimit te hollesishem, ne menyre qe zerat dhe vellimet e punes te jene te percaktuara mire ne dokumentet e tenderit.

Ndertimet mund te prokurohen me punime ne matje, me cmime te pandryshueshme atehere kur vellimet e punes te dhena ne projekt mund te ndryshojne gjate zbatimit. Ne kete rast fituesi i tenderit eshte i detyruar te mbaje te pandryshueshem cmimet njesi te dhena ne oferten e paraqitur.

Ndertimet mund te prokurohen edhe me celesa ne dore atehere kur vellimet e punes te dhena ne projekt jane orientuese dhe shoqerite konkurruese duhet te bejne nje studim te hollesishem te projektit, duke mos qene te detyruara t'u permbahen ketyre vellimeve. Ne kete rast fituesi i tenderit ka pergjegjesine e dorezimit te objektit pa pretenduar asnje shtese fondi mbi vleren e ofertes se paraqitur ne tender, me te cilen eshte shpallur fitues, duke iu pergjigjur brenda kesaj vlere te gjitha detyrimet fiskale sipas ligjeve ne fuqi.

Specifikimet teknike duhet te shprehin qarte kerkesat e entit prokurues ne lidhje me cilesine e cdo punimi, materialet qe do te perdoren, si dhe kerkesa te tjera qe ka enti prokurues, pervec kerkesave te parashikuara ne projekt zbatimin e kushtet teknike.

Kontratat dhe aktet e kolaudimit perfundimtare te tyre, per objekte te ngjashme, te realizuara gjate aktivitetit te shoqerise ne tre vitet e fundit, ku te pakten vlera e nje objekti te jete jo me e vogel se 50 % e vleres se objektit qe prokurohet.

Nese sipermarresi ploteson te gjitha kerkesat per kualifikim dhe specifikimet teknike te percaktuara ne dokumentat e tenderit vleresohet per cmimin (dhe afatin, ne qofte se ky eshte parashikuar si kriter vleresimi ne dokumentet e tenderit), qe paraqet ne oferten ekonomike, ku si çmim do te merret vlera e plote e preventivit.

Vellimet e punes duhet te jene te plota me te gjitha zerat dhe perqindjet qe enti prokurues gjykon se duhen fiksuar, (si p.sh fondi rezerve, minimumi i fitimit te planifikuar, minimumi i shpenzimeve plotesuese, perqindja e T.V.SH etj.) per rastet kur kontratat parashikohen me punime ne matje me cmime te ndryshuara.

Radhe e punimeve dhe perfundimi i fazave te ndryshme ose i nenobjekteve, duhet dhene n.q.s. enti prokurues e gjykon te nevojshme qe punimet duhen kryer detyrimisht sipas nje radhe te caktuar.

Kriter vleresues do te jete cmimi me i ulet.

Per sipermarrjen e rikonstruksioneve, kur nuk ka projekt zbatimin te plote e te detajuar, enti prokurues mund te perdore proceduren e prokurimit te tenderit me dy faza. Ne baze te specifikimeve teknike te nevojshme, ne fazen e pare do te kerkoje nga konkuresit, pervec kerkesave per kualifikim, volumet e punes dhe eventualisht mendime te tjera ne lidhje me realizimin e objektit dhe, mbasi te fiksoje volumet e punes, ne fazen e dyte te kerkoje nga kandidatet vetem cmimin e ofertes.

Persa u perket kerkesave per kualifikim, specifikimeve teknike dhe kriterëve te vleresimit do te procedohet si ne pikat paraardhese per sipermarrjet e ndertimit.

2. Per mallrat

Menyra e levrimit te mallit do te jete sipas kriterëve te vendosura nga enti prokurues ne dokumentat e tenderit.

Ne rast se kerkohet ne dokumentat e tenderit, kontratat per levrimin e mallrave duhet te garantojne pagese te plote per mallrat e kontraktuara pas levrimit dhe kontrollit te tyre, me perjashtim te kontratave per instalimin dhe venien ne pune. Ne te tilla raste nje pjese e pageses mund te kryhet pasi furnizuesi te kete permbushur te gjitha detyrimet e veta kontraktuese. Duhet t'i jepet perparesi menyres se pageses me L/C (leter kredi) te pakthyeshme te konfirmuar nga Bankat Shqiptare qe te sigurohet pagesa e menjehershme per furnizuesin.

Specifikimet teknike duhet te shprehin qarte pershkrimin e mallit ne lidhje me cilesine, funksionimin, sigurine, permasat, simbolet, terminologjine, ambalazhimin, marketimin dhe etiketimin, ne baze te nenit 14 te ligjit nr.7971 dt.26.07.1995.

Grafiku i levrimit te mallrave duhet te jape qarte menyren dhe afatet qe enti prokurues kerkon per levrimin e mallit.

Mbasi te jene plotesuar specifikimet teknike dhe afatet e levrimit, kriteri i vetem i vleresimit te ofertave do te jete çmimi i mallit.

Ne rastet kur kriteret e vleresimit jane me shume se nje dhe ne varesi te objektit te prokurimit, kriteret tjera qe mund te merren parasysh jane, shpenzimet per transportin e brendshem dhe sigurimin deri ne vendin e dorezimit, grafiku i pagesave, koha e levrimet, shpenzimet operative, efektiviteti dhe pershtatshmeria e pajisjeve, si dhe gadishmeria e sherbimeve dhe e pjeseve te kembimit etj. Per te gjitha keto faktore, vec cmimit, qe do te perdoret per te percaktuar oferten me te leverdishme, enti prokurues duhet te percaktoj metodologjine e vleresimit per secilin kriter te shprehur ne vlere monetare.

3. Per sherbimet

Lloji i sherbimit duhet te jete i shprehur sakte, me te gjitha kerkesat specifike te entit prokurues ne cilesi dhe ne afat.

Nese kerkesat e entit prokurues jane te qarta dhe te plota, atehere kriteri i vetem i vleresimit te ofertave mund te jete cmimi i sherbimit.

Ne rastet kur kriteret e vleresimit jane me shume se nje dhe ne varesi te objektit te prokurimit, kriteret tjera qe mund te merren parasysh jane eksperienca e meparshme, personeli qe do te kryeje kete sherbim, etj. Per te gjitha keto faktore, vec cmimit, qe do te perdoret per te percaktuar oferten me te leverdishme, enti prokurues duhet te percaktoj metodologjine e vleresimit per secilin kriter te shprehur ne vlere monetare.

3.1 Per sherbimet e projektimit.

Detyra e projektimit duhet te jete e plote dhe e qarte, ne menyre qe t'u jape mundesi te barabarta te gjitha konkuresve. Ne te detyrimisht duhet te percaktohet fondi i parashikuar per ndertimin e objektit.

Ne specifikimet teknike duhet te shprehen sakte te gjitha kerkesat qe enti prokurues ka per projektimin e objektit, anen funksionale e teknologjike te vepres, rifiniturat dhe materialet qe duhen perdorur, etj.

Ne kerkesat per kualifikim duhet te jepen qarte kerkesat minimale ne lidhje me:

- kualifikimet dhe licencat e personave qe do te merren drejtperdrejte me projektimin e objektit, drejtimin e punimeve ose konsulencen, d.m.th. curriculum vitae te secilit person;
- projektet e ngjashme, gjithnje te vertetuara me certifikatat nga punedhensesit,(n.q.s.jane projektuar para vitit 1992, vlere e plote e tyre do te llogaritet me koeficientin e konvertimit.)

Pervec kerkesave per kualifikimin, kandidateteve do t'u kerkohet, sipas gjykimit te komisionit, skice idea ose projekt idea, dhe preventivi paraprak, me cmime te njejta per te gjitha konkuresit, (enti prokurues, ne dokumentat e tenderit do te jape udhezimet perkatese se si do te merren keto cmime). Kandidatet gjithashtu duhet te paraqesin cmimin e projektit, i cili duhet te jete kriter konkurrimi.

Gjate pergatitjes se dokumentave te tenderit per sherbimet e projekteve, sipas nenit 39, pika 2/c, duhet te kihet parasysh qe te shenohet ne dokumentat e tenderit qe te gjitha kandidatet duhet te perjashtohen nga prokurimet e mallrave apo ndertimeve qe kane lidhje me projektin ne fjale.

Ne dokumentat e tenderit per sherbimet e projekteve, ne urdherin e prokurimit, fondi i vene ne dispozicion eshte vlere e pageses se projektit dhe jo fondi i plote i objektit, ky i fundit do te jepet ne detyren e projektimit.

Kriteret vlereuese per projektimet do te jene jo me pak se 75 pike per oferten teknike, d.m.th. cilesine e projektit, rreth 15 pike per oferten ekonomike, d.m.th. vleren e preventivit paraprak dhe rreth 10 pike per cmimin e vete projektit.

Preventivi i projektzbatimit, pas reflektimit te te gjitha verejtjeve te keshillit teknik, nuk mund te tejkaloj vleren e preventivit paraprak te hartuar ne baze te projektidese dhe te

paraqitur per konkurrim; ne rast te kundert, projektuesit i mbahet garancia bankare e sigurimit te kontrates.

Nje projektues nuk mund te paraqitet njekohesisht ne stafin e dy shoqerive projektuese te ndryshme, qe marrin pjese ne tender per te njejtin objekt.

Ne rastet kur do te prokurohet nje projekt zbatimi, projektideja e te cilit eshte e percaktuar ne vija te pergjithshme, dhe me nje tender te zakonshem projektimi nuk do te merreshin zgjidhje te ndryshme nga njera tjetra, arsye per te cilen krahasimi i tyre nuk do te kishte kuptim (p.sh.sistemim asfaltim rrugesh eksistuese, rrjete ujesjellesi e kanalizimesh te cileve u njihet traseja, etj), mund te perdoret tenderi me dy faza.

Ne fazen e pare kandidateve do t'u kerkohej preventivi paraprak me cmime te njejta per te gjitha konkuresit, (enti prokurues, ne dokumentat e tenderit do te jape udhezimet perkatese se si do te merren keto cmime), se bashku me detaje te projekt idese, te cilat mund te influencojne ne vleren e ketij preventivi.

Mbasi enti prokurues te vendose, ne baze te ofertave te ardhura, variantin me te mire se bashku me preventivin paraprak, shpall fazen e dyte te tenderit per te marre ofertat per cmimin e vete projektit.

Kriteri i vetem i vleresimit ne kete rast eshte vlere me e ulet e ofruar..

KAPITULLI IV

KOMISIONI I VLERESIMIT TE OFERTAVE DHE NJESIA E PROKURIMIT (HARTUESIT E DOKUMENTEVE TE TENDERIT)

Komisioni i vleresimit te ofertave perbehet nga jo me pak se 5 anetare, midis te cileve specialiste te fushes dhe ekonomist. Kryetar i komisionit rekomandohet te jete zevendestitullari i entit prokures. Titullari i entit prokurues nuk mund te jete kryetar komisioni.

Njesia e prokurimit (ose hartuesit e dokumentave te tenderit) perbehet nga jo me pak se 2 specialiste te fushes se prokurimit dhe nje jurist.

Njesia e prokurimit (hartuesit e dokumentave te tenderit), se bashku me komisionin e vleresimit te ofertave, te percaktuar ne urdherin e prokurimit, harton dokumentet e tenderit, sipas detyrave te percaktuara ne kete udhezim.

Ne raste te vecanta, ne varesi nga kompleksiteti i objektit qe prokurohet, dokumentat e tenderit mund te pergatiten edhe nga nje organ teknik i specializuar, vendas a i huaj.

Ne rastet e prokurimeve **te mesiperme**, komisioni i vleresimit te ofertave duhet te kete vleren e nje keshilli teknik. Ai do te perbehet nga jo me pak se 7 specialiste te fushes.

Ne prokurimet e projektive enti prokurues do te caktojte edhe oponencat per secilin projekt.

Njesia e prokurimit (hartuesit e dokumentave te tenderit) ka pergjegjesi per shpalljen e njoftimeve ose shperndarjen e ftesave per oferte, dergimin per botim, ne afat, te fteses per oferte ne buletinin e prokurimeve publike, sigurimin e materialeve per plotesimin e dokumentacioneve te tenderit (si hartat, detyrat e projektimit, projektet, preventivat, kushtet teknike, standartet, etj), pergatitjen e dokumenteve te tenderit me formularet perkates dhe zbatimin e afateve, sipas rregullave te prokurimit publik, te percaktuara me vendim te Keshillit te Ministrave dhe sipas ketij udhezimi, llogaritjen e cmimit me te cilin do t'u shiten dokumentet e tenderit kandidateve (duke u bazuar ne nenin 27 te ligjit nr.7971, date 26.07.1995 "Per Prokurimin Publik") dhe dorezimin e ketyre dokumenteve kandidateve qe deshirojne te marrin pjese ne tender.

Juristi që ben pjesë ne grupin e hartuesve të dokumenteve të tenderit, ka përgjegjësinë e zbatimit të procedurave, mbështetur ne legjislacionin ne fuqi dhe të drejtën e pezullimit të këtyre procedurave, kur ve re shkeljen e tyre.

Komisioni i vleresimit të ofertave merr pjesë, së bashku me njesinë e prokurimit, ne përpilimin e dokumenteve të tenderit dhe ka përgjegjësi për pjesën e vecantë të këtyre dokumenteve që ka të bëjë me specifikimet teknike dhe kërkesat për kualifikim si dhe për vendosjen e kriterëve të vleresimit.

Gjate përgatitjes së ofertave nga kandidatët, njesia e prokurimit ka për detyrë sqarimin e kandidateve për çdo paqartësi, që mund të këne gjatë hartimit të ofertave për dokumentacionin e marrë nga entitë prokurues, deri në çastin e hapjes së ofertave. Ne rast se sqarimi qëndron ne një interpretim të kërkuar me shkrim ose ne një shtojcë që duhet dhënë nga ana e entitë prokurues, atehere, bazuar ne nenin 28 të ligjit nr.7971 dt.26.07.1995 "Për Prokurimin Publik", ky sqarim duhet t'u dërgohet me shkrim të gjithë kandidateve, pavaresisht ne e kanë kërkuar apo jo, dhe bëhet pjesë përberëse e dokumenteve të tenderit.

N.q.s. për sqarimet e kandidateve, është e nevojshme të merret mendimi i komisionit të vleresimit të ofertave, atehere njesia e prokurimit, nepermjet kryetarit të komisionit, duhet të kërkojë mbledhjen e komisionit dhe nëse është e nevojshme të organizojë edhe një takim të kandidateve me komisionin.

Per tenderat kombetare afati i fundit i dorezimit të ofertave do të jete ai i percaktuar ne dokumentat e tenderit.

Ne vendin, ditën dhe orën e caktuar në ftesën për oferte, në prani të përfaqësuesve të shoqërive pjesëmarrëse, komisioni ben pranimin e ofertave për tenderat kombetare, dhe hapjen e ofertave kur, në tenderat nderkombetare, pranimitë është bere me pare.

Anetaret e komisionit të vleresimit të ofertave nuk duhet të këne lidhje pune, gjaku apo interesash me ofertuesit. Për këte ato leshojnë deklarata përkatëse para hapjes së zarfave.

Ofertat e paraqitura nga kandidatët merren në dorezim nga Komisioni i Vleresimit të Ofertave, i cili ben pranimin e tyre dhe në prani të ofertuesve hidhen në një kuti të vecantë, e cila vendoset në një vend të dukshëm Me pas Komisioni i Vleresimit të Ofertave do të proçedojë me hapjen e ofertave.

Pas hapjes së ofertave të paraqitura nga ofertuesit, një nga anetaret e Komisionit të Vleresimit të Ofertave lexon me zë të lartë emrin e ofertuesit, dokumentacionin administrativo-ligjor kualifikues dhe vlefshëm të çdo oferte, dhe i regjistron në procesverbal, i cili hartohet në zbatim të nenit 31/3 të ligjit nr.7971 dt.26.07.1995 "Për prokurimin publik".

Entitë prokurues do të shqyrtojë të gjitha dokumentat e paraqitura ne çdo oferte për të konfirmuar në se ato janë ne përputhje të plote me dokumentat e tenderit dhe për të përcaktuar plotshmërinë e çdo dokumenti të paraqitur. Në se ndonjë prej dokumentave të kërkuar mungon ose është i paplotë, oferta do të refuzohet.

Entitë prokurues do të shqyrtojë çdo oferte për të konfirmuar në se ajo është konform ndaj të gjitha kërkesave të paraqitura në dokumentat e tenderit dhe në se i përmbush të gjitha afatet dhe kushtet. Oferta që është konform ndaj të gjitha kërkesave duke përfshirë afatet dhe kushtet konsiderohet e vlefshme.

Entitë prokurues do të vlerësojë dhe krahasojë ofertat që janë kualifikuar si të vlefshme me qëllim që të përcaktojë ofertën fituese në përputhje me procedurat dhe kriteret e paraqitura në dokumentat e tenderit. Asnjë kriter tjetër nuk do të përdoret n.q.s nuk parashikohet në dokumentat e tenderit.

Te gjitha fletët që paraqesin llogaritjen e vlerës përfundimtare të ofertes firmosën nga të gjithë anetaret e komisionit.

Dokumentacioni i hapur nga komisioni ben pjese ne dosjen e tenderit dhe nuk u kthehet ofertuesve as mbas mbylljes se tenderit.

Mbas pranimit te ofertave, komisioni i vleresimit te ofertave ka detyren dhe pergjegjesine e perzgjedhjes se ofertes me te leverdisshme, duke u bazuar ne kriteret e vendosura ne dokumentet e tenderit, ne perputhje me nenin 32 te ligjit 7971 dt.26.07.1995 dhe klasifimin e shkallezuar te te gjitha ofertave te tjera.

Ne rast se pas vleresimit te ofertave tekniko-ekonomike, rezultojne oferta te barabarta, atehere kur oferta fituese nuk eshte zgjedhur me mirekuptim **ofertuesi fitues** do te percaktohet nga shorti i hedhur ndermjet ofertuesve qe kane paraqitur oferta te barabarta.

Vendimet e komisionit do te merren me konsensus ose me shumice votash te deklaruar, jo me votim te fshehte.

Njesia e prokurimit duhet te jete prezent gjate gjithe punes se komisionit te vleresimit, mund te jape mendime ose te beje verejtje.

Ajo ka detyren te mbaje dhe te nenshkruaje te gjithe proces verbalet e punes se komisionit, te cilat detyrimisht duhet te jene te nenshkruara nga te gjithe anetaret e komisionit te vleresimit te ofertave, te mbledhe e te organizoje ne nje dosje te gjithe dokumentacionin e tenderit (qe nga urdheri i prokurimit, njoftimet, etj deri te vendimi i shpalljes se fituesit) dhe ne perfundimin e prokurimit ta dorezoje dosjen ne arkivin e entit prokurues, ku do te ruhet sipas **menyres dhe kohes qe parashikohet ne ligjin per arkivat dhe ligjin per informinin publik.**

Kryetari i komisionit te vleresimit te ofertave organizon mbarevajtjen e punes se komisionit gjate procedures se prokurimit deri ne klasifikimin perfundimtar te ofertave.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave perpilon klasifikimin perfundimtar te ofertave, i cili nenshkruhet nga Kryetari i komisionit, dhe ia njofton ate zyrtarisht ofertuesve.

KAPITULLI V

ANKIMI ADMINISTRATIV

Ofertuesit qe nuk jane dakord me vendimin e entit prokurues dhe duan te dine shkaqet e mospranimit te ofertes se tyre, kane te drejte te ankohen prane entit prokurues brenda 5 diteve nga data e marrjes se njoftimit zyrtar.

Ne kete rast do te diskutohet vetem per oferten e ofertuesit qe ankohet dhe jo per ofertat e konkuresve te tjere.

Titullari i entit prokurues mund te ktheje tenderin per rishqyrtim n.q.s. gjykon qe ankesa eshte me vend, ose ne te kundert ka per detyre te sqaroje dhe t'i jape pergjigje, ne baze te pikes 2 te nenit 44 te ligjit 7971, dt.26.07.1995 "Per Prokurimin Publik", te gjitha ankesave, te cilat kane ardhur ne entin prokurues brenda **5 ditesh** nga njoftimi zyrtar i klasifikimit te ofertave nga komisioni i vleresimit.

Ofertuesi qe nuk eshte dakord me pergjigjen e entit prokurues, ka te drejte te ankohet sipas pikes 3 te nenit 44 te ligjit 7971, date 26.07.1995 "Per Prokurimin Publik".

KAPITULLI VI

MIRATIMI

Enti prokurues harton nje raport permbledhes sipas pikes 2 te nenit 7 te ligjit 7971 dt.26.07.1995 "Per Prokurimin Publik", ku pasqyrohen te gjitha ankesat, nese ka, pergjigjet

perkatese dhe i dergon ne organin qendror apo vendor i cili ve ne dispozicion fondin, ose ne Agjencine e Prokurimit Publik ne perputhje me rregullat e prokurimit publik, te percaktuara me vendim te Keshillit te Ministrave.

Titullari i organit, qe ve ne dispozicion fondin, apo Agjencia e Prokurimit Publik, ne baze te raportit dhe ankesave te mundshme te derguara nga enti prokurues, gjykon nese eshte e nevojshme te kerkohet shqyrtimi i plote i dokumentacionit te tenderit, ne rast te kundert ai miraton klasifikimin e ofertave dhe urdheron veprimet e metejshme.

Pas shqyrtimit te dokumentacionit te kerkuar, organi qendror apo vendor, apo Agjencia e Prokurimit Publik, jo me vone se 30 dite nga marrja e ketij dokumentacioni, duhet te japin miratimin a masa korrigjuese, nese ka.

Vetem mbas miratimit te organit qe ve ne dispozicion fondin apo Agjencise se Prokurimit Publik, enti prokurues ka te drejte te shpalle fituesin dhe te lidhe kontraten per objektin e prokuruar.

Cdo shpallje fituesi ose lidhje kontrate perpata miratimit me shkrim te organit qe ve ne dispozicion fondin apo Agjencise se Prokurimit Publik, eshte e pavlefshme.

Titullari i entit prokurues mbas miratimit nga organi qendror apo vendor, apo Agjencia e Prokurimit Publik, njofton pjesemarrresin, i cili shpallet fitues, perpara perfundimit te periudhes se vlefshmerise se ofertes, sipas formularit te dhene ne dokumentet e tenderit.

Periudha e vlefshmerise se ofertes do te llogaritet nga njesia e prokurimit, duke mbledhur kohen qe enti prokurues parashikon qe do t'i duhet per shqyrtimin e ofertave nga ana e komisionit, me kohen e domosdoshme sipas rregullave per pritjen e ankesave dhe miratimin perkates, deri ne nenshkrimin e kontrates.

Ne rast se organi qendror apo vendor, i cili ve ne dispozicion fondin apo Agjencia e Prokurimit Publik, e kthen per rivleresim ne entin prokurues klasifikimin e ofertave, atehere periudha e vlefshmerise se ofertes mund te shtyhet dhe per kete njofton me shkrim te gjithe kandidatet e kualifikuar.

Dokumentet e tenderit jane pjese perberese e kontrates qe nenshkruhet nga palet.

KAPITULLI VII

TE PERGJITHSHME

Bashkimi i perkohshem i shoqerive do te pranohet te marre pjese ne tender me kusht qe :

- te kete nje kontrate te noterizuar, ndermjet shoqerive, ku te saksesohen punimet qe do te kryeje secila shoqeri dhe menyra se si do te ndahet fitimi per kete objekt prokurimi;

- te caktohet me prokure te posacme njera prej shoqerive si kryesuese e bashkimit te shoqerive, e cila do te perfaqesoje ne tender deri ne nenshkrimin e kontrates, si dhe ne cdo tratative tjeter, shoqerite e tjera pjesetare te bashkimit te perkohshem;

- bashkimi i shoqerive te jete kryer perpara dites se hapjes se ofertave.

- secila shoqeri te paraqese dokumentacionin ligjor dhe administrative perkates, sipas kerkesave te vendosura ne dokumentet e tenderit.

Te gjitha kushtet e pjesemarrjes ne tender te bashkimit te shoqerive duhet te jepen qarte ne dokumentacionin e tenderit.

Nensipermarrja. Kur sipermarrresi ka nder mend te realizoje nje pjese te punimeve me nenkontraktues, duhet te paraqese ne oferte, sipas dokumentave te tenderit, gjithe

dokumentacionin e kerkuar per nenkontraktuesit si dhe punimet konkrete qe do te jape me nensipermarrje

Procedurat qe ndiqen ne rast te mossigurimit te konkurrences.

Procedurat e prokurimit do te perseriten per proceduren "Tender i hapur" kur:

- paraqitet vetem nje oferte ose kur pas shqyrtimit te ofertave mbetet vetem nje oferte e vlefshme

Procedurat e prokurimit do te perseriten per proceduren "Tender i kufizuar" dhe "Kerkese per kuotim" kur:

- paraqiten me pak se tre oferta
- ofertat nuk i plotesojne kerkesat per kualifikim dhe specifikimet tekniko-ekonomike dhe ne gare mbeten me pak se tre ofertues.

Ne kete rast enti prokurues duhet te nxjerre shkaqet e refuzimit te ofertave, te rishikojte dokumentet e tenderit dhe te ribeje procedurat e prokurimit.

Ne procedurat "Tender i kufizuar" dhe "Kerkese per kuotim" duhet te rishikohet edhe lista e shoqerive te ftuara ne konkurim.

Kur enti prokurues edhe pas riberjes se procedurave "Tender i kufizuar" dhe "Kerkese per kuotim", veren mungese te konkurrences, kerkon miratim per vazhdimin e procedures me me pak se tre oferta ne Agjencine e Prokurimit Publik, ne mbeshtetje te shkronjes "d" te nenit 36 dhe te pikes 1 te nenit 40 te ligjit nr. 7971, date 26.7.1995 "Per Prokurimin Publik".

Shtyrja e procedures se prokurimit. Shtyrja e procedurave te prokurimit nga enti prokurues per shkaqe objektive duhet te shoqerohet me procesverbalin perkates, te nenshkruar nga anetaret e komisionit te vleresimit te ofertave dhe te njesise se prokurimit. Per kete shtyrje te dates se zhvillimit te procedures se prokurimit duhet te njoftohen te gjitha kandidatet, te cilet kane terhequr dokumentat e tenderit dhe te dokumentahet ky njoftim.

Dokumentat Standarte te Tenderit per mallrat, ndertimet dhe sherbimet dhe Manuali i Perdoruesit miratohen bashke me kete udhezim. Dokumentat Standarte te Tenderit, bashkelidhur Udhezimit te Keshillit te Minsitrave nr.1, date 01.01.1996 "Per prokurimin publik" shfuqizohen.

Ky udhezim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE

FATOS NANO